



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 251, datë 27.3.2020

P Ë R

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.269, DATË 29.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN
E KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET
E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË
TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR
TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE
PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEM NGA TARIFA VJETORE
E SHKOLLIMIT", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të neneve 1 e 5, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996, "Për statusin e jetimit", të ndryshuar, të neneve 2 e 8, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000, "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", të ndryshuar, të neneve 1 e 15, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994, "Për statusin e invalidit të punës", të ndryshuar, të nenit 5, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, "Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës", të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993, "Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist", të ndryshuar, të ligjit nr.57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.9642, datë 20.11.2006, "Për ratifikimin e konventës së Këshillit të Evropës, "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Nënndarja "iv", e shkronjës "c", të pikës 1, të vendimit nr.269,

datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iv) studentët, të cilët kanë, të paktën, njërin prind person me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar;”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I ARSIMIT,
SPORTIT DHE RINISË

BESA SHAHINI

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

NR.PROT. 1853/1
DATË 30.3. 2020

MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË BRENDSHME
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT
INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGACI

